



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 23

Prishtinë, më 12 qershor 2018, në orën: 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Shqipe Pantina, Arban Abrashi, Xhevahire Izmaqi, Rasim Selmanaj, Milaim Zeka dhe Albert Kinolli.

Munguan: Jasmina Zhivkoviç, Valon Ramadani, Fisnik Ismaili dhe Imet Rrahmani.

Në mbledhje morën pjesë: anëtarët e KPMSHCK-së, OSBE, KDI, Ekonomia Online.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, për vitin 2017;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, për vitin 2017

Nait Hasani, njoftoi komisionin se në bazë të dispozitave të Ligjit për KPMSHCK-në, KPMSHCK-ja raporton për çdo vit kalendarik. Gjithashtu, njoftoi se Këshilli ka adresuar raportin në Kuvend, sipas afatit të paraparë ligjor.

Shkëmb Manaj, kryetar i KPMSHCK-së, prezantoi raportin, si përmbledhje të punës dhe aktiviteteve të Këshillit për vitin 2017 dhe pasqyron kryerjen e funksioneve kushtetuese dhe ligjore të Këshillit, si institucion i pavarur kushtetues për mbikëqyrjen e respektimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit të shërbimit civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës zbaton legjislacionin për shërbimin civil nga institucionet e administratës publike të nivelit qendror dhe lokal dhe ka dëshmuar që ka punuar me përkushtim, në mënyrë të paanshme, që shërbimi civil të jetë profesional dhe i paanshëm, si dhe të pasqyrojë diversitetin e popullit të Kosovës, duke përfshirë parimin e barazisë gjinore.

Gjithashtu, theksoi se sfidë e Këshillit, për vitin 2017, ka qenë ngritja enorme e ankesave, që nuk është pasojë e shkeljeve më të shumta në shërbimin civil, por si një vetëdijesim më i madh i nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, që të shfrytëzojnë të drejtën e ankesës, në rastet kur vlerësojnë që iu kanë cenuar të drejtat nga marrëdhënia e punës, si dhe një besim i shtuar në vendimmarrjen e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës.

Sa i përket funksionit monitorues të Këshillit, Këshilli ka evidentuar dhe ka konstatuar 523 (pesëqind e njëzet e tre) shkelje të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil dhe për shkeljet e evidentuara ka dhënë 524 (pesëqind e njëzet e katër) rekomandime për zyrtarët përgjegjës të institucioneve të monitoruara.

Sipas të dhënave të raportit, KPMSHCK, gjatë vitit 2017, ka pasur në shqyrtim gjithsej 891 ankesa.

Po ashtu, gjatë vitit raportues, Këshilli ka miratuar Kodin e ri të Etikës së Këshillit, si dhe për herë të parë ka nxjerrë Planin Zhvillimor Strategjik për vitin 2017-2019.

Shqipe Pantina, pyeti: Duke pasur parasysh faktin se ka shkelje nga institucionet me rastin e shpalljes se konkurseve, sa shkelje ka dhe a ka përmirësime? Për ushtruesit e detyrës, të cilët mbajnë pozitën përtej afateve të përcaktuara me ligj, a ka përmirësime në respektimin e afateve?

Xhevahire Izmaku, në kontekst të ngritjes së vetëdijesimit të shërbyesve civilë për paraqitjen e ankesave, a janë të njoftuar personat në fjalë për rekomandimet e Këshillit, si dhe për ndryshimin e infrastrukturës ligjore për shërbimin civil?

Arban Abrashi, pyeti për monitorimin në Komunën e Prishtinës dhe komunat në pjesën veriore të Kosovës.

Milaim Zeka, kërkesa e tij ishte që në prezantim të raportit mos t'u jepet hapësirë shifrave të prezantuara në raport, por objektit të ankesave, sepse kjo e bën raportin përmbajtësor.

Shkëmb Manaj, iu përgjigj pyetjeve të deputetëve: te shkeljet e konkurseve ka përmirësime, sidomos në nivelin lokal dhe këto shkelje, në të ardhmen, nuk do të jenë mbi bazën e faktit, sepse intervistimi tutje do të jetë elektronik.

Sa i përket zbatimit të vendimeve të Këshillit, të gjitha komunat kanë zbatuar vendimet, me përjashtim të Komunës së Prishtinës dhe Komunës së Zubin Potokut, në të cilat komuna ka ngecje.

Te tejkalimi i afateve ligjore për pozitën ushtrues detyre ka përmirësime, të cilat shkelje janë evituar në proceset e monitorimit.

Vlen të theksohet se vendimet e Këshillit janë përfundimtare dhe të zbatueshme në afatin prej 15 ditësh, pavarësisht paraqitjes së ankesës në gjykatë, procedurës së konfliktit administrativ.

Konstatim: Komisioni, pas diskutimeve, unanimisht e miratoi raportin dhe nxori këtë,

R e k o m a n d i m:

1. Të miratohet Raporti vjetor i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2017.
2. Arsyetimin e raportit me rekomandime e paraqet deputeti, Nait Hasani, kryetar i komisionit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 19 të Ligjit nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ia paraqet raportin vjetor të punës, Kuvendit të Kosovës.

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në mbledhjen e mbajtur më 12.6.2018, shqyrtoi Raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2017 dhe vlerësoi se Raporti vjetor i punës është në pajtim me nenin 19 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Mbledhja përfundoi në ora: 11:30.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Nait Hasani